



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2018:025472
Datë: 07.08.2018
Numri i dokumentit: 00108322

P.nr.818/17

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Mentor Bajraktari, me procesmbajtësen Nushe Kadrija – sekretare juridike pranë kësaj gjykate, në lëndën penale kundër të akuzuarit K. B. nga Gjakova, për shkak të veprës penale: rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë – Departamenti përgjithshëm, me numër PP/II.nr.1523/2017, të datës 29.11.2017, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datë 07.08.2018, në prezencën e Prokurorit të shtetit Ismet Tofaj, të dëmtuarës R. B. si dhe të akuzuarit, në të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

K. B., nga i ati N, e ëma Z, e gjinisë J, data e lindjes ... në fshatin M, Komuna e Gjakovës, tani me vendbanim në Gjakovë në rrugën “...”, i martuar, baba i gjashtë fëmijëve, ka të kryer shkollën e tri vite të shkollës fillore, pensionist, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar – shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal:

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse me datën 28.09.2017, rreth orës 19:05 minuta, në rrugën lokale Gjakovë-P., pikërisht në fshatin M., Komuna e Gjakovës, përball pompës të derivate ..., rrezikon trafikun publik duke shkelur nenin 59 dhe nenin 61 lidhur me nenin 255 të Ligjit Rregullat e Trafikut Rrugor, duke venë në rrezik jetën e njerëzve dhe pasurinë nga pakujdesia edhe pse ka qenë i vetëdijshëm se pasoja e ndaluar mund të ndodhë si pasojë e veprimit apo mosveprimit të tij, por me mendje lehtësi mendon se ajo nuk do të shkaktohet apo se ai mund të ndaloj shkaktimin e saj dhe pasoja është shkaktuar, në atë mënyrë që duke drejtuar automjetin e markës “...”, me targa të regjistrimit, me ngjyrë hiri merr veprim të kthimit majtas nga rruga kryesore për të hyrë në pompën e derivateve në mënyrë të pasigurte, ku si pasojë pasi kalon në shiritin e majtë ndeshet me automjetin të markës “.....”, me targa të regjistrimit ..., me ngjyrë të bardhë, të cilën e drejtonte F.Q. i cili në momentin kritik ishte në përball kalim, i cili në pamundësi për ti ikur goditjes pasi distanca ishte e shkurt, me pjesën e përparme ballore të automjetit të tij e ka

goditur automjetin e markës transporter”, në pjesën ballore, me ç’rast përpos dëmeve materiale në automjet, lëndime të lehta trupore pësojnë i dëmtuari F.Q. si dhe bashkudhëtarët e tij B. Q.dhe Sh. Q. si dhe i akuzuari dhe bashkudhëtarja e tij R. B., lëndime të konstatuara dhe të përshkruara hollësisht në ekspertizën mjeko-ligjore të ekspertit Dr.M. G. të datës 14.11.2017.

Me këto veprime ka kryer veprën penale: rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në kuptim të neneve 4, 7, 17 par.1, 41, 42, 43, 46, 73, 74 dhe nenit 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së, të akuzuarin e:

G J Y K O N

ME DËNIM ME GJOBË në shumë prej 200 (dyqind) Euro, të cilin dënim i akuzuari duhet ta paguajë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj dënimin me gjobë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi atëherë të akuzuarit dënimi me gjobë i zëvendësohet me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) ditëve, ashtu që për çdo ditë të kaluar në burgim do të llogaritet nga 20 (njëzet) Euro.

Të dëmtuarit: F. (F.) Q., Sh. (F.) Q., B. (B0) Q. që të tre nga fshati M, Komuna e Gjakovës si dhe R. (N.) B. nga Gjakova, me vendbanim në rrugën “...”, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohen në kontest të rregullt juridiko-civil.

Detyrohet i akuzuari K. B., që ti paguajë shpenzimet e procedurës penale dhe atë: për ekspertizën mjeko-ligjore shumë prej 50 Euro, për ekspertizën e komunikacionit në shumë prej 40.88 Euro si dhe shpenzimet e paushallit gjyqësorë në shumë prej 40 Euro, ndërsa për programin për kompensimin e viktimave të krimit shumë prej 30 (tridhjetë) Euro, të gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë-Departamenti i përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.1523/2017, të datës 29.11.2017, kundër të akuzuarit K. B. nga Gjakova, për shkak të veprës penale: rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së. Prokurori i shtetit Ismet Tofaj, gjatë shqyrtimit fillestar ka qëndruar në tërësi pranë aktakuzës kundër të akuzuarit K. B., andaj ka propozuar që i njëjti të shpallët fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

I akuzuari K. B. gjatë shqyrtimit fillestar ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, duke theksuar se i vjen keq për rastin që ka ndodhur kjo ka ndodhë nga pakujdesia dhe gjykatës i ka premtuar që në të ardhmen nuk do të përsëris veprime të këtilla të jetë më i kujdesshëm.

Në shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Në tërësi është vërtetuar se i akuzuari K. B., me datën 28.09.2017, rreth orës 19:05 minuta, në rrugën lokale Gjakovë-P., pikërisht në fshatin M., Komuna e Gjakovës, përball pompës të derivate ..., rrezikon trafikun publik duke shkelur nenin 59 dhe nenin 61 lidhur me nenin 255 të Ligjit Rregullat e Trafikut Rrugor, duke venë në rrezik jetën e njerëzve dhe pasurinë nga pakujdesia edhe pse ka qenë i vetëdijshëm se pasoja e ndaluar mund të ndodhë si pasojë e veprimit apo mosveprimit të tij, por me mendje lehtësi mendon se ajo nuk do të shkaktohet apo se ai mund të ndaloj shkaktimin e saj dhe pasoja është shkaktuar, në atë mënyrë që duke drejtuar automjetin e markës "...", me targa të regjistrimit ..., me ngjyrë hiri merr veprim të kthimit majtas nga rruga kryesore për të hyrë në pompën e derivateve në mënyrë të pasigurte, ku si pasojë pasi kalon në shiritin e majtë ndeshet me automjetin të markës "....", me targa të regjistrimit ..., me ngjyrë të bardhë, të cilën e drejtonte F.Q. i cili në momentin kritik ishte në përball kalim, i cili në pamundësi për ti ikur goditjes pasi distanca ishte e shkurt, me pjesën e përparme ballore të automjetit të tij e ka goditur automjetin e markës "...", në pjesën ballore, me ç'rast përpos dëmeve materiale në automjet, lëndime të lehta trupore pësojnë i dëmtuari F.Q. si dhe bashkudhëtarët e tij B. Q.dhe Sh. Q. si dhe i akuzuari dhe bashkudhëtarja e tij R. B., lëndime të konstatuara dhe të përshkruara hollësisht në ekspertizën mjeko-ligjore të ekspertit Dr.M. G. të datës 14.11.2017.

Gjykata gjendjen e këtyllë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari, i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë, gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga i akuzuari është bërë në pajtim me nenin 248 të KPP-së. Gjatë pranimit të fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatoi se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjet që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike dhe se nuk ekziston asnjë nga rrethanat e parapara në nenin 253 paragrafët 1 dhe 2 të KPP-së, për pushimin e procedurës penale përkatësisht hedhjen e aktakuzës.

Gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin të shpall fajtor dhe të gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 dhe 74 të KPRK-së të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit se: se është baba i gjashtë fëmijëve, është i moshuar-pensionist, në gjykim ka patuar qëndrim tejet korrekt, pranimin e fajësisë në shqyrtimin fillestar, pendimin e tij dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të kryejë vepra penale do të jetë më i kujdesshëm, faktin se më parë nuk ka qenë i dënuar. Kështu që duke mos gjetur rrethana rënduese gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin e shqiptuar si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 41 dhe 50 i KPRK-së dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari dhe se dënimi i shqiptuar do të ndikoj në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëjë rehabilitimin e tij, do të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe do të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi mbi udhëzimin e palëve të dëmtuara, për realizimin e kërkesës pasurore juridike në kontest të rregullt juridiko-civil është marrë në kuptim të nenit 463 par.2 lidhur me par.1 të KPP-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe shpenzimet e paushallit gjyqësor është marrë konform nenit 450 par.1 dhe 2 lidhur me nenin 453 par.1 të KPP-së, ndërsa për programin për kompensimin e viktimave të krimit është marrë konform nenit 39 par.3 nënpar.3.1 të Ligjit Nr.05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 365 të KPP-së.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
- Departamenti i përgjithshëm -
P.nr.818/2017, me datë 07.08.2018

Procesmbajtësja,
Nushe Kadrija

Gjyqtari i vetëm gjykses,
Mentor Bajraktari

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese, në afat prej 15 ditëve, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.